




Rreth nesh



4. Kërkesë padinë e plotësuar për lëshimin e UMM, punonjësi i policisë e dërgon në Gjykatën e Rrethit dhe për çdo rast kontakton me përfaqësuesen(in) e gjykatës.

5. Kur paraqitet e domosdoshme për shkak të riskut për jetën e viktimës, punonjësi i policisë i sugjeron titullarit të strukturës së policisë vendosjen e viktimës në një qendër rezidenciale publike apo jo-publike emergjente ose afatgjatë.

6. Kur rasti është viktimë të dhunës seksuale, punonjësi i policisë në bashkëpunim me KVDHF dhe/ose NJMF/PMF kur flitet për të mitur, referon rastin për t'u trajtuar pranë Qendrës së Menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale "LILIUM".

7. Nëse nevojiten shërbime avokatie, atëhere punonjësi i policisë dhe KVDHF kontakton me OJF-të e specializuara në ofrimin e këtyre shërbimeve, ose me zyrën përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë apo edhe me Zyra Avokatie Falas.

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, jo-politike, e cila punon për fuqizimin e grave dhe vajzave, mbron të drejtat e tyre dhe lufton pabarazitë gjinore.

Vizioni: 'Të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për gratë dhe vajzat!'

Misioni: Qendra për Drejtësi Gjinore jep kontributin e saj për krijimin e një shoqërie ku të gjitha gratë të jetojnë një jetë me dinjitet, pa diskriminim dhe me mundësi të barabarta.

Na kontaktoni

Website

www.gjalbania.org

Email

office@gjalbania.org
genderjusticealbania@gmail.com

Adresa

Rr: "Medar Shtylla", Nd. 26/5, Ap. 77,
Tiranë, Shqipëri

Telefon

+355692667531

**POLICIA E SHETIT
PËR NJË PËRGJIGJE
EFEKTIVË NDAJ
DHUNËS NË FAMILJE**



**BROSHURË PËR PUNONJËS TË
POLICISË**

VLERËSIMI I RISKUT

Policia ka të drejtë që kur vlerëson se situata mund të paraqesë rrezik të lartë për jetën, shëndetin dhe lirinë e viktimës së dhunës në familje, të lëshojë Urdhër për Masa Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM).

TREGUESIT E RREZIKSHMËRISË SË LARTË

- Dhuna e ushtruar ndaj viktimës ka rrezikuar jetën dhe shëndetin e saj;
- Dhunuesi vuan probleme të shëndetit mendor;
- Situatat e dhunës në familje janë të përsëritura (viktima është paraqitur në mënyrë të përsëritur në Polici apo institucionet e tjera ku raportohet dhuna në familje);
- Dhunuesi nuk ka respektuar masat në vendimet e mëparshme të Urdhërave të Mbrojtjes;
- Dhunuesi është dënuar më parë për veprën penale “Dhunë në familje”;
- Dhunuesi disponon armë;
- Gjendja psikologjike e rënduar e dhunuesit;
- Dhunuesi është përdorues i alkoolit apo lëndëve narkotike.

HAPAT PËR MENAXHIMIN E RASTIT

1. Identifikimi dhe/ose raportimi i rastit.

2. Vlerësimi i riskut dhe përgatitja e raportit. Punonjësi i Policisë së bashku me KVDHF / punonjësit(es) social(e) / PMF të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në njësinë e vetëqeverisjes vendore, karyen vlerësimin e riskut dhe harton raportin.

3. Menaxhimi i rrezikut. Menaxhimi i rrezikut mund të përfshijë miratimin nga Shefi i Komisariatit të Policisë të Urdhërit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme, vendosjen e viktimës në një qendër rezidenciale emergjente ose afatgjatë.

4. Monitorimi i rastit. KVDHF bashkëpunon me strukturën përgjegjëse të Policisë së Shtetit për monitorimin e zbatimit të masave të UMPMM-së.

5. Vlerësimi dhe mbyllja e rastit. Ekipi Teknik Ndërdisciplinar (ETN), pas monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm, kur e konsideron se janë përbushur të gjitha veprimet e planifikuara për ndjekjen e një rasti dhe secili institucion ka kryer me përgjegjshmëri detyrimet e tij, vendos mbylljen e rastit.

MENAXHIMI I NJË RASTI EMERGJENT

Rasti, në të cilin nga kryerja e vlerësimit të riskut rezulton se dhuna e ushtruar paraqet nivel të lartë të rrezikut për jetën, shëndetin, mirëqenien dhe lirinë e anëtarëve të familjes, konsiderohet si rast emergjent për t'u menaxhuar.

Hapat për t'u ndjekur:

1. Njoftohet menjëherë KVDHF dhe strukturat shëndetësore nëse viktima ka dëmtime ose shqetësime shëndetësore. Në rastin kur janë përfshirë të mitur njoftohet njëkohësisht Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve pranë njësisë vendore dhe psikologu. Kryhet vlerësimi i riskut.

2. Nëse KVDHF ose punonjësi/ja social/e nuk paraqiten në kohë, punonjësi i policisë kryen pa vonesë vlerësimin e riskut dhe hartimin e raportit, nëse bëhet fjalë vetëm për viktimë të rritur. Ndërsa në rastin e viktimës së mitur, prania e NJMF/PMF është domosdoshmëri për procesin e vlerësimit të riskut.

3. Policia bashkëpunon me njësinë e vetëqeverisjes vendore për marrjen e masave për veçimin e dhunuesit(es) nga familja.